



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË**

**VENDIM  
Nr. 1 datë 08.10.2021**

**PËR SHPALLJEN E KANDIDATËVE FITUES PËR ANËTARË GJYQTARË TË  
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Në mbështetje të pikës 7, të nenit 17, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Votimit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përbërë nga anëtarët:

Engjëllushe TAHIRI	Kryetare
Enisa SHAHINI	Anëtare
Lorena ÇABEJ	Anëtare

Bazuar në rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij,

**VENDOSI:**

1. Të shpallë emrat e kandidatëve fitues për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si vijon:
  - 1) Klodian Kurushi shpallet fitues për Gjykatën e Lartë;
  - 2) Ridvan Hado shpallet fitues për Gjykatën e Apelit;
  - 3) Irena Plaku shpallet fitues për Gjykatën e Shkallës së Parë;
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve, duke nisur ky afat nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe në Fletoren Zyrtare. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I VOTIMIT**

**ANËTARE  
Enisa SHAHINI**

**KRYETARE  
Engjëllushe TAHIRI**

  

**ANËTARE  
Lorena ÇABEJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË

VENDIM  
Nr. 2 datë 08.10.2021

PËR SHPALLJEN E KANDIDATIT FITUES TË KËSHILLIT DREJTUES TË  
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të nenit 247 pika 1 shkronja “d”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Votimit, për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, i përbërë nga anëtarët:

Engjëllushe TAHIRI	Kryetare
Enisa SHAHINI	Anëtare
Lorena ÇABEJ	Anëtare

Bazuar në rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij,

**VENDOSI:**

1. Të shpallë kandidat fitues për anëtarë të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës Z. Genti Dokollari.
  2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.
- Tiranë, më 08.10.2021.

**KOMISIONI I VOTIMIT**

ANËTARE  
Enisa SHAHINI

KRYETARE  
Engjëllushe TAHIRI



ANËTARE  
Lorena ÇABEJ